

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

“HIPPO” Sh.P.K.

Neni 1
Emertimi i Shoqerise

Sot ne Tirane ne daten 6 Korrik 2015 me vullnetin e lire Ortaket e Shoqerise:

Z.Meland Qirko, e datelindjes 15.05.1977, lindur ne Vlorë, me shtetesi shqiptare, pajisur me karten e identitetit numer H85322179J

Z.Alban Fejzaj, i datelindjes 16.05.1985, lindur ne Tiranë, me shtetesi shqiptare, pajisur me karten e identitetit numer I50516147U.

Vendosen: te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar emertimi i se ciles do te jete “HIPPO” SH.P.K.

Neni 2
Selia e Shoqerise

Shoqeria do ta kete seline e saj ne qytetin e TIRANES, Rruga “Kongresi i Lushnjes”, ne Pallatin A&EM nr 31, por me Vendimin e Asamblese se Ortakeve, mund te ngrihen edhe dege, filiale apo dhe seli ne vende te tjera, brenda dhe jashte territorit te Shtetit Shqiptar.

Neni 3
Kohezgjatja e Veprimtarise

Kohezgjatja e veprimtarise do te jete 10 vjet te njepasnjeshem, por me Vendim te Asamblese se Ortakeve, ky afat mund te riperterihet.

Neni 4
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga 100.000 (njqindmije leke), i ndare ne 2 kuota, i cili eshte teresisht kapital financiar e perbehet nga kontributi i ortakeve si me poshte:

Z. Meland Qirko, zoteron nje kuote e njesuar me 50% te kapitalit, me vlere nominale te barabarte me 50.000 Leke (pesedhjetë e njemijë leke).

Z. Alban Fejzaj, zoteron nje kuote e njesuar me 50% te kapitalit, me vlere nominale te barabarte me 50.000 Leke.

Ortaket kane te drejte ta tjetërsojne kete kapital, te shtojne apo te pakesojne kuotat e kapitalit deri ne kufijte e percaktuara nga ligji.

Neni 5
Objekti i Veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj Shoqerie do te jete:

- Aktivitet ne fushen e tregtise : Import –Eksport si dhe tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem te lejuar nga ligji, mallrave ushqimore dhe industriale, te materialeve te ndertimit, hidrosanitare, hidraulike, makinave dhe automjeteve te tonazheve te ndryshme, pllakave te te gjitha llojeve, plastikes, gomes, lendeve drusore dhe mobiljeve, linjave te prodhimit dhe perpunimit, makinerive te llojeve dhe tonazheve te ndryshme, por pa u kufizuar vetem ne keto, pervec mallrave tregtimi i te cilave kerkon license te vecante si dhe *importimin e lendeve te pare per prodhim.*
- Aktivitet ne fushen e marketingut: Funksione te agjentit te shitjes per shoqeri vendase dhe te huaje, duke hapur dege apo zyra ne vende te huaja per arritjen e objektivave te shoqerise, duke kryer te gjitha veprimet qe lidhen me kete veprimtari.
- Aktivitet ne fushen e sherbimeve : Hapje agjensish –turistike, spedicioni, detare, transporti, shitje per shoqeri vendase dhe te huaja etj.
- Hapja e Bar- Restoranteve, Picerive e aktivitet ne fushen e Hoteleri-Turizem.
- Transport per vete dhe te trete, nacional e internacional.
- Distributor ne tregun vendas dhe te huaj

Me zgjerimin e aktivitetit, shoqeria mund te beje shtesa te ndryshme ose ndryshime te objektit te veprimtarise se saj, duke bere ndryshimet perkatese ne Statut.

Neni 6
Administratori

1. Shoqëria do te administrohet dhe perfaqesohet nga nje Administrator i cili do te jete **Meland Qirko**.
2. Mandati, detyrat dhe kompetencat e tij percaktohen ne statut.
3. Administratori ka te drejte t'i delegoje pjesisht apo plotesisht te drejtat e tij cdo personi te trete.

Neni 7
Shperberja dhe likuidimi

Shoqeria shperbehet per arsyet e parashikuara nga ligji dhe me:

- a. per mbarimin e afatit.
- b. per pamundesi te funksionimit ose per inaktivitet te vazhduar te asamblese,
- c. per reduktimin e kapitalit nen minimumin ligjore.
- d. me vendim te asamblese e per arsye te tjera te parashikuara me ligj



Ne te gjitha hipotezat e shperberjes, asambleja e ortakeve, do te caktoje nje ose me shume likuidatore duke percaktuar numrin e likujdvesve si dhe kriteret ne baze te te cilave do kryhet likuidimi.

Neni 8

E gjithë veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe ligji nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" si dhe ne Legjislacionin ne pergjithesi te Republikes se Shqiperise.

Neni 9

Ky Akt Themelimi u nenshkrua ne pese kopje te barazvlefshme sot me daten 6 Korrik 2015 (gjashte korrik dymije e pesembedhjete).

Asambleja e Ortakeve:


Meland Qirko

Alban Fejzaj
